

# SHPJEGIMI I TË TË DREJTAVE TUAJA

Nëse **NUK JENI NDALUAR** dhe do të merreni në pyetje si si dyshuar

1/2

## 1. E drejta e një konsultimi konfidencial me një avokat dhe ndihma gjatë intervistës

### A. Kur?

- Ju keni të drejtën e konsultimit konfidencial me një avokat përpara se të intervistoheni dhe të ndihmës ligjore gjatë intervistës.
- Nëse shkeljet për të cilat po intervistoheni janë të dënueshme me burgim, zbatohet procedura e përcaktuar në pikën c.

### B. Cilin avokat?

- Ju mund të konsultoheni me një avokat që e zgjidhni vetë.
- Në kushte të caktuara ligjore, ju mund të kërkonti një avokat nëpërmjet sistemit të ndihmës ligjore, i cili është krejtësisht ose pjesërisht falas. Ju mund të kërkonti formularin që përmban një përmbledhje të këtyre kushteve. Më pas do t'i kërkonti zyrës së ndihmës ligjore të Shoqatës së Avokatëve që t'ju caktohet një avokat.

### C. Si do të bëhet konsultimi konfidencial?

Nëse ju është dërguar një ftesë me shkrim që rendit të drejtat tuaja të specifikuar nën numrat 1 deri 4 dhe thuhet se pretendohet se jeni konsultuar me një avokat përpara se të paraqiteshit në intervistë:

- Nuk do t'ju jepet shtyrja pasi ju keni pasur mundësinë që të konsultoheshit me një avokat.
- Nëse nuk kërkonti të ndihmoheni nga një avokat, duhet të këshilloheni për të drejtën tuaj që të qëndroni i heshtur përpara se të fillojë intervista (shih edhe pikën 3).

Nëse nuk iu është dërguar një ftesë me shkrim ose ju është dërguar një ftesë me shkrim e paplotë:

- Ju mundeni që vetëm një herë të kërkonti shtyrjen e intervistës për një datë ose orë të mëvonshme në mënyrë që të mund të konsultoheni me avokatin tuaj.
- Ju mund të zgjidhni që të bëni një bisedë telefonike me avokatin tuaj, pas së cilës mund të fillojë intervista.
- Ju mund të prisni që avokati juaj të mbërrijë në vendin e intervistës.

### D. Ndihma ligjore gjatë intervistës

Avokati juaj do të sigurojë:

- që të respektohet e drejta juaj për të heshtur dhe e drejta juaj për të mos e shpallur veten fajtor
- që të trajtoheni mirë gjatë intervistës dhe që të mos detyroheni ose të mos ushtrohet asnjë presion i jashtëligjshëm mbi ju;
- që të informoheni për të drejtat tuaja dhe që intervista të kryhet në përputhje me ligjin.

Nëse avokati juaj ka ndonjë koment mbi këtë pikë, ai ose ajo mund t'i shënojë ato menjëherë në procesverbal. Avokati juaj mund të kërkojë që të bëhet një hetim i caktuar ose që të intervistohet një person i caktuar. Ai mund të kërkojë sqarime në lidhje me pyetjet që bëhen. Ai mund t'ju thotë komente në lidhje me hetimin dhe intervistën. Atij nuk i lejohet që t'i përgjigjet pyetjeve për ju ose ta pengojë intervistën.

# SHPJEGIMI I TË TË DREJTAVE TUAJA

Nëse **NUK JENI NDALUAR** dhe do të merreni në pyetje si si dyshuar

2/2

E. A mund të heq dorë nga kjo e drejtë?

Ju nuk jeni i detyruar të kërkonti konsultim me ose ndihmë nga një avokat.

Ju mund të hiqni dorë nga kjo e drejtë vullnetarisht dhe pasi e keni menduar seriozisht:

- nëse jeni në moshë madhore;
- kur të keni nënshkruar një dokument ku është shënuar dhe data, ku thuhet se ju hiqni dorë nga kjo e drejtë.

## 2. Komunikimi i përmbledhjes së shkeljeve

- Ju keni të drejtën t'ju thuhet shkurtimisht shkeljet për të cilat do të intervistoheni.

## 3. E drejta për të qëndruar të heshtur

- Në asnjë pikë nuk do të jeni i detyruar të shpallni veten fajtor.
- Pasi të deklaroni identitetin tuaj, ju mund të zgjidhni të bëni një deklaratë, t'i përgjigjeni pyetjeve që ju bëhen ose të heshtni.

## 4. Të drejta të tjera gjatë intervistës

Përpara intervistës juve do ju jepen disa informacione. Përveç një informacioni të shkurtër rreth fakteve dhe të drejtës për të heshtur, ju do t'ju thuhet se:

- Ju mund të kërkonti që të gjitha pyetjet që bëhen dhe përgjigjet që ju jepni për këto pyetje të regjistrohen ashtu siç jepen;
- Mund të kërkonti që të bëhet një hetim i caktuar ose që të intervistohet një person i caktuar;

- Deklaratat tuaja të bëra mund të përdoren si prova përpara një gjykate ligjore.
- Nuk jeni i arrestuar dhe jeni i lirë që largoheni kur të doni në çdo kohë.
- Gjatë intervistës, ju mund të përdorni të gjitha dokumentet që keni në pronësi, për sa kohë që, me qëllim që të veproni kështu, intervista nuk shtyhet. Gjatë ose pas intervistës ju mund të kërkonti që këto dokumente t'i bashkëngjiten procesverbalit me shkrim ose të depozitohen te kancelari i gjykatës.

## 5. Në përfundim të intervistës

Në përfundim të intervistës, do t'ju jepet teksti i intervistës në mënyrë që ta lexoni. Ju gjithashtu mund të kërkonti që këtë t'ju lexojë dikush tjetër.

Ju do t'ju kërkohet nëse do të donit të bënit ndonjë ndryshim ose sqarim në deklaratat tuaja.

## 6. Ndhimja e interpretuesit dhe e drejta për përkthim

- Nëse nuk e kuptoni apo flisni gjuhën, ose nëse keni vështirësi në dëgjim ose të folur, do të thirret një interpretues i vënë nën betim që t'ju ndihmojë gjatë intervistës. Kjo ndihmë është falas.
- Mund t'ju kërkohet që ta shkruani në gjuhën tuaj deklaratën..
- Nëse nuk e kuptoni gjuhën e procedurës, keni të drejtë të merrni pjesët përkatëse të përkthyer me shkrim të urdhër-arrestit, fletëthirrjes dhe vendimit të gjykatës në një gjuhë që e kuptoni. Kjo ndihmë është pa pagesë.

**Këtë deklaratë të të drejtave tuaja mund ta mbani.**